

V E N D I M
Nr. 43, datë 17.1.1998

PËR ORGANIZIMIN E PANAIREVE DHE EKSPOZITAVE TREGTARE

Me propozimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Panairët dhe ekspozitat tregtare, si dhe veprimtaritë tregtare të ngjashme me to në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, të organizohen vetëm në mjedise të specializuara e të përshtatshme.

2. Panairët dhe ekspozitat tregtare me karakter kombëtar e ndërkombëtar të organizohen në bazë të një kalendarit vjetor, i cili miratohet nga Ministria e Tregtisë dhe Turizmit, pasi të ketë marrë më parë mendimin e ministrive të interesuara ose organeve të pushtetit lokal, sipas llojit të panairit a ekspozitës.

3. Shoqëritë që merren me organizimin e panairove dhe ekspozitave pajisen paraprakisht me licencë nga Ministria e Tregtisë dhe Turizmit, e cila lëshohet në përputhje me aftësitë teknike, profesionale dhe garancitë financiare të shoqërive, sipas kriterëve të vendosura në rregulloren e Ministrisë së Tregtisë dhe Turizmit.

Nuk i nënshtrohen licencimit dhomat e tregtisë dhe industrisë, të cilat veprojnë sipas ligjit nr.7804, datë 10.3.1994 “Për dhomat e tregtisë dhe industrisë”.

4. Të krijohet Qendra Kombëtare e Panairove me seli në Tiranë, si person juridik publik jobuxhetor në vartësi të Ministrisë së Tregtisë dhe Turizmit.

Objekti kryesor i kësaj qendre është përkujdesja për përgatitjen dhe ushtrimin e veprimtarisë së panairove dhe ekspozitave tregtare.

Statuti i Qendrës Kombëtare të Panairove miratohet nga Ministri i Tregtisë dhe Turizmit.

5. Panairët dhe ekspozitat ndërkombëtare të një rëndësie të veçantë kulturore e politike, me propozimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Turizmit dhe me miratimin e Ministrisë së Shtetit pranë Kryetarit të Këshillit të Ministrave, mund të organizohen edhe në mjedise të tjera, të përshtatshme për rëndësinë e tyre.

6. Pasuria që ka në përdorim panairi i Tiranës, si dhe buxheti i parashikuar për gjashtëmujorin e parë të vitit 1998 për panairin e Tiranës i kalojnë Qendrës Kombëtare të Panairove.

7. Ngarkohet Ministria e Tregtisë dhe Turizmit të nxjerrë rregulloren përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

8. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 411, datë 22.8.1994 “ Për krijimin e panairit të Tiranës” dhe nr.57, datë 11.9.1978 “Për miratimin e rregullores për përgatitjen e ekspozitave dhe pavioneve në panairët ndërkombëtarë” shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij nga data 1 janar 1998.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano